



Prishtinë, e enjte 25 shtator 2008

PROCESVERBAL

Prezantim i Draft Rregullës së Autorizimit dhe ndryshimet në Rregullat për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

Seancën e ka hapur Kryesuesi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), Z. Ali Hamiti, i cili ka falënderuar te pranishmit për pjesëmarrje dhe i ka njoftuar me qëllimin e këtij dëgjimi. Z. Hamiti ka sqaruar se në këtë dëgjim do të prezantohet drafti i parë i Rregullës për Autorizimin e Ndërtimit të kapaciteteve të reja në sektorin e energjisë në Kosovë, si dhe prezantimin e tri rregullave, për të cilat ka pasur kërkesa dhe ZRRE-ja ka vlerësuar se është e nevojshme të bëhen disa ndryshime.

Z. Hamiti theksoj se qëllimi i ndryshimeve të këtyre tri rregullave është që ato të bëhen sa me efikase dhe të lehta për përdorim, si për ndërmarrjet e energjisë ashtu edhe për konsumatorët, pasi që ZRRE-ja është e përkushtuar që të baraspeshojë interesat e ndërmarrjeve të energjisë me ato të konsumatorëve, në mënyrë që ato të jenë të drejta, transparente dhe jo diskriminuese për asnjërën palë.

Sa i përket Rregullës së Autorizimit Z. Hamiti tha se deri më tani janë përgatitur disa variante dhe janë zhvilluar diskutime paraprake dhe se tani besohet se është një variant i cili meriton të shqyrtohet dhe se më komentet dhe vlerësimet e publikut do të bëhet një rregull e zbatueshme.

Prezantimi i Rregullës për Autorizimin e Ndërtimit të Kapaciteteve të Reja është bërë nga Afrim Ajvazi, Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Departamentit për çështje Ligjore dhe Licencim në ZRRE.

Z. Ajvazi njoftoi të pranishmit se me përgatitjen e kësaj rregulle është filluar qysh në vitin 2006, ku dhe me ndihmën e konsulentëve të huaj janë përgatitur dy variante, varanti i parë sipas Z. Ajvazi është konsideruar më i komplikuar dhe i vështirë për interpretim, ndërsa tani është versioni i dytë i cili është mjaft i thjeshtësuar.

Z. Ajvazi njoftoi se versioni që do të prezantohet është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së me 23 qershor dhe ju është dërguar të gjitha palëve të interesit për komente, por deri me sot nuk është pranuar asnjë koment.

Në prezantimin e tij Z. Ajvazi ka paraqitur bazën ligjore për nxjerrjen e kësaj rregulle gjegjësisht nenin 38 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë ku thuhet se “Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese.....duhet të bazohet ose në procedurën e autorizimit ose në atë të tenderimit”, ky nen sipas Z. Ajvazi

korrespondon me përmbajtjen e Direktivës së UE 2003/54 (neni 6) lidhur me autorizimin e kapaciteteve të reja prodhuese.

Z. Ajvazi theksoj se nxjerrja e këtij Rregulli nuk do të shfuqizoj cilindo autoritet ekzistues apo cilindo institucion qeveritar ose institucion tjetër që të lëshoj leje, pëlqime apo ndonjë dokument tjetër, në pajtim me mandatin dhe autoritetin e dhënë institucioneve sipas ligjeve të Kosovës.

Pastaj në prezantim është paraqitur iniciimi i procedurës – aplikacioni, ku është thënë se procedura iniciohet me shkrim (aplikacioni) dhe në formatin e specifikuar në këtë Rregull, aplikacionit duhet ti

bashkëngjiten dëshmitë e përcaktuara me nenin 6 dhe të precizuara në shtojcën 2 dhe 3. u tha se në nenin 5 janë përcaktuar kriteret që duhet ti plotësoi një projekt për ndërtim (teknologji moderne, financat, përvoja etj dhe se prej nenit 6-10 të këtij Rregulli përshkruhen veprimet administrative që ndermirën nga aplikuesi dhe ZRRE-ja.

Ndër çështje të tjera të rëndësishme për tu theksuar Z. Ajvazi i paraqiti edhe atë se Investitori mund të aplikojë për Autorizim në çdo kohë dhe ti lëshohet *Njoftimi mbi vendimin preliminar* i cili e udhëzon atë që ti siguroj dëshmitë tjera të domosdoshme që lëshohen nga institucionet tjera relevante (brenda 2 vitesh), ai tha se sipas dëshirës investitori mund të pres deri më vonë dhe tek atëherë të aplikojë për autorizim.

Gjithashtu u tha se ZRRE-ja nuk bënë zgjedhje në mes aplikantëve. Nëse dy investitor potencial aplikojnë për të njëjtin projekt ose projekte të ngjashme atëherë të dyve mund tu jepet Njoftimin mbi vendimin preliminar nëse të dytë i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë Rregull.

Në fund u theksua se ky Rregull nuk shtjellon çështjet që kanë të bëjnë me tenderimin.

Komentet nga publiku:

Naim Bejtullahu, KOSTT: Kriteri D, kriteri i shërbimit publik nuk vlen për gjeneratorët e energjisë por në vend të kësaj të futet se mund ti imponohet gjeneruesve obligimi “last resurs supply”.

Përgjegjje: Ky koment është pranuar, dhe do të inkorporohet në rregull pra do të rregullohet kjo çështje.

Naim Bejtullahu, KOSTT: ka shtruar pyetje në lidhje me skemën, tek pjesa e burimeve të ripërtrishme, Cila është baza për të lejuar tarifën, pasi që aplikuesi duhet të dorëzoj studimin e fizibilitetit.

Përgjegjje nga Azem Kastrati, ZRRE: Kjo çështje është e përfshirë në rregull dhe parashihet që të paraqes studimin e para zbatueshmërisë.

Në fund të prezantimit të kësaj Rregulle është kërkuar nga pjesëmarrësit që të dërgojnë komente e tyre me shkrim.

Seanca ka vazhduar me prezantimet e Ndryshimeve në Rregullat për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë ky prezantim është bërë nga Azem Kastrati, Kryesues i Departamentit për Përkujdesje të Konsumatorëve në ZRRE.

Z. Kastrati ka njoftuar të pranishmit se duke marrë parasysh kërkesat e parashtruara nga KEK sh.a. dhe mandatin ligjor të ZRRE-së të përcaktuar në nenin 15.2 h) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe në Nenin 40 të Kapitullit 8 të Rregullës për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur për fillimin e procesit të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullës për Shkycje dhe Kycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.

Z. Kastrati sqaroi se kërkesa për ndryshimin e këtyre Rregullave ka ardhur nga KEK sh.a. me 26.06.2008 nr 346 / 9 dhe është plotësuar me kërkesën e datës 15.08.2008 me të cilat është kërkuar ndryshimi dhe plotësimi i Rregullës për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, kjo kërkesë ka ardhur pas problemeve të shfaqura gjatë implementimit nga i licencuari.

Ai gjithashtu njoftoi pjesëmarrësit se deri me atë ditë nga palët e interesuara kanë marrë komente nga Zyra e Kryeministrit – Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike, të cilët kanë dërguar shkresën me të cilën kjo zyrë është shprehur se me ndryshimet e propozuara në përgjithësi janë përfshirë vërejtjet e KEK-ut, si dhe janë inkorporuar paragrafët e Urdhrit të përkohshëm të Qeverisë.

Gjithashtu ai njoftoj për komentet e pranuar nga KEK sh.a. dhe propozimet e tyre për ndryshimin e Rregullës për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë , si dhe për komentet e KOSTT sh.a. në propozim ndryshimet në Rregullën për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Gjithashtu nga OJQ Konsumatori janë pranuar komente në të tri rregullat në të cilat kërkohet involvim më i madh i shoqatës së konsumatorëve në rastet e ndërprerjeve të energjisë, kualitetin e furnizimit dhe shërbimit, si dhe në rastin zgjidhjes së kontesteve. AK njoftoi se disa prej propozimeve do të inkorporohen në rregullat e reja.

Z. Kastrati njoftoi se nga palët tjera të cilave ua kemi dërgua dokumentet nuk është dërguar asnjë koment.

Ai theksoi se komentet e bëra nga KEK sh.a. dhe KOSTT sh.a. kanë të bëjnë vetëm me rregullën për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, dhe nuk ka komente në propozim ndryshimet e vogla të dy rregullave tjera.

Gjatë prezantimit të ndryshimeve të propozuara komentet nga publiku kanë qenë:

Naim Bejtullahu, KOSTT, Të saktësohet në rregull se si do ta përcaktoj ndërmarrja e energjisë nëse një konsumator ka prekur njehsorin me qëllim për të vjedhur (ka abuzuar)
Komenti është pranuar nga ZRRE-ja

Ali Hamiti, ZRRE, Nganjëherë Ndërmarrja e energjisë mund ta vlerësoj gabimisht se konsumatori po bën shfrytëzim të paautorizuar, prandaj duhet të sanksionohet me rregull se kur konsiderohet se është abuzim ose shfrytëzim i paautorizuar

Naim Bejtullahu, KOSTT, shfrytëzim i paautorizuar mundet me qenë edhe brenda shtëpisë, ngase është e caktuar fuqia e cila i lejohet konsumatorit nga ndërmarrja dhe kjo duhet të theksohet se në rregull.

Përgjigje nga Azem Kastrati, ZRRE, kjo është precizuar në nenet në vazhdim të rregullës

Ismet Latifi, KEK, çka të bëhet me rastet kur konsumatori shkyçet nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit dhe pastaj kërkon energji elektrike nga të afërmit përreth (kojshitë).

Përgjigje nga Azem Kastrati, ZRRE, është abuzim ngase është jashtë pronës dhe se kojshia nuk ka drejtë të furnizoj konsumatorin me energji elektrike për atë edhe është theksuar se është jashtë pronës.

Naim Bejtullahu, KOSTT, duhet që këtu t'i referoheni nenit i cili e përcakton kufijtë se sa ka drejtë konsumatori përtej lejes së dhënë të shpenzoj, pra të bëhet referimi dhe atëherë është e qartë.

Përgjigje nga Azem Kastrati, ZRRE, pra ky nen t'i referohet nenit i cili e përcakton kufirin, në rregull mund të bëhet kjo dhe do t'i referohemi.

Ali Hamiti, ZRRE, konsumatorit i cili është i rregullt në pagesë nuk është mirë t'i shkojë njoftimi paralajmërues por vetëm atyre që kanë borxh.

Petrit Pepaj, KEK, nëse mbetet 30 ditë njoftimi paralajmërues nga data e afatit të pagesës atëherë po bëhet shumë po bëhet 45 ditë andaj duhet të mbetet ajo që është e propozuar nga ana e KEK-ut.

Naim Bejtullahu, KOSTT, nuk duhet të hiqet obligimi për ndërmarrjen e energjisë, që të dërgoj njoftimin për shkyçje tek konsumatorët që janë shpërngulur, njoftimi duhet gjithsesi ti dërgohet konsumatorit edhe nëse ai nuk është aty njoftimi duhet të lihet tek dera ose në

ndonjë vend tjetër, pika e) nuk duhet të hiqet por duhet të mbetet dhe ajo është proces juridik.

Komenti është pranuar nga ZRRE-ja

Petrit Pepaj, KEK, nuk duhet të merret konfirmimi për konsumatorët të cilët i kanë borxh KEK-ut vlera të mëdha të shumave.

Naim Bejtullahu, KOSTT, nuk duhet të hiqet përgjegjësia e Rregullatorit për trajtimin e ankesave të konsumatorëve për vjedhje të energjisë, pasi që ky është një obligim ligjor për ZRRE-në dhe do ti shkaktonte një problem të madh ZRRE-së.

Përgjegje nga Nysret Avdiu, ZRRE, pasi që vjedhja është vepër penale, nuk është në mandatin e ZRRE-së që të merret me veprat penale, kjo është kompetencë e gjykatave dhe instancave tjera.

Naim Bejtullahu, KOSTT, kur është çështja për shkyçjen e konsumatorëve në tensionin e lartë, pra kur është në pyetje ndonjë konsumator i madh, duhet që kërkesa për shkyçje të kaloj së pari në Rregullator e pastaj të kërkohej nga OST-ja ta kryej shkyçjen, nuk mundet që Transmisioni t'i evaluoj të gjitha dokumentet, duhet që kërkesa apo vendimi të vij nga Rregullatori.

Përgjigje e Azem Kastrati, ZRRE kërkesa e furnizuesit duhet fillimisht të kaloj nëpër të gjitha procedurat e parapara dhe pastaj rregullatori i evaluon dhe merr vendim.

Komenti është pranuar, për ta plotësuar rregullën me fjalinë "Pas përfundimit të procedurave për shkyçje"

Driton Hyseni N.Q. TERMOKOS, periudha e rikuperimit të humbjeve që ka qenë më herët të mos ndryshohet por të mbetet ajo e vjetra ngase për ngrohtoret është shumë vështirë të përcaktohet ngase ne kemi një njehsor në nënstacion dhe nuk mund të dimë se ku ka ndodh shfrytëzimi i paautorizuar

Përgjigje e Azem Kastrati, ZRRE, për ngrohtoret është edhe më lehtë ngase periudha është vetëm gjashtë muaj dhe keni shumë më pak konsumator andaj mund të bëni kontrolla më të shumta të konsumatorëve dhe të përcaktoni shfrytëzimin e paautorizuar ju mund të jepni koment dhe ne do të analizojmë.

Ismet Latifi, KEK, në kushte të sotshme janë duke u bërë keqpërdorime të shumta nga ana e konsumatorëve rreth shfrytëzimit të paautorizuar, ngase është shumë vështirë të përcaktohet andaj periudha 12 muaj për amvisëri dhe 24 muaj për komercial duhet të mbetet.

Naim Bejtullahu, KOSTT, para se t'i lëshohet fatura e rikthimit të humbjeve konsumatorit KEK-u duhet të analizoj dhe shqyrtoj faturat e konsumatorit, pra duhet të obligohet KEK-u që të bëjë këtë.

Ismet Latifi, KEK, kur gjykata vendos në favor të konsumatorit dhe konsumatori është shkyçur çka atëherë.

Përgjigja e Azem Kastrati, ZRRE, në rastet kur konsumatori shpallet i pafajshëm nga ana gjykata atëherë KEK-u duhet t'i paguaj me kamatë konsumatorit për periudhën sa konsumatori ka qenë pa furnizim, edhe pse realisht nuk ka dëmshpërblim për konsumatorët të cilat janë shkyçur nga rrjeti e shpallen të pafajshëm nga gjykata.

Nazmi Gashi, KEK, zyra e rregullatorit e KEK-ut ka përgatitur një propozim të ri lidhur me shfrytëzimin e paautorizuar, pra kur konsumatori pas analizimit të bërë rrjedhjes së energjisë dhe analizimit tjetër bërë nga KEK-u ai duhet të shkyçet

Përgjigja e Azem Kastrati, ZRRE, vërtetësia është vetëm e njëjës palë andaj nuk mundet KEK-u vetëm sipas vërtetimit të njëanshëm ta shkyç konsumatorin.

Osman Stollqaku, KEK, zyra e rregullatorit për tarifa në KEK ka bërë një propozim në qershor ku kemi vazhduar dhe e kemi shtuar nenin 19 në të cilin theksohet se konsumatorit pasi t'i bëhet konstatimit (kalibrimi, kontrolla etj) ti bëhet fatura për rikthim të humbjeve ku përfshihet sasia e energjisë së paautorizuar dhe gjoha e cila do t'i shqiptohet konsumatorit dhe se konsumatori nuk mundet të kyçet në rrjet derisa nuk i përmbush obligimet në faturë ku ankesa e ngritur në ndërmarrje apo në ZRRE nuk nënkupton suspendimin nga fatura, ngase mungesa e një dispozite ka mundësuar një komoditet për konsumatorët e pandërgjegjshëm dhe ndërmarrja e energjisë ka qenë e paaftë në realizimin e gjobave për rikthim të humbjeve. Ndërsa në rastet kur shpallet i pafajshëm konsumatori nga ana e ZRRE-së apo gjykata atëherë konsumatori duhet të kompensohet sipas nenit 19.5 ku përcaktohet edhe norma e interesit e cila do t'i bëhet konsumatorit

Përgjigja e Azem Kastrati, ZRRE, këto janë vetëm për ata konsumator të cilët bëjnë keqpërdorim me energji elektrike, por për ata konsumatorë të cilët narkohen e janë të pafajshëm, ngase në asnjë vend tjetër nuk mundet vetëm njëra palë në kontest ta zgjidh rastin por nevojitet pala e tretë të analizojë dhe të përcaktojë edhe dënimin.

Ismet Latifi, KEK, konsumatorët të cilët bëjnë keqpërdorime me të cilat edhe konstatohet se ka keqpërdorur atëherë ai vetëm bënë ankesë në ZRRE apo në gjykatë dhe ai mbetet ende duke u furnizuar me energji dhe kjo e rëndon punën e KEK-ut prej së cilës nuk mund të dalim

Azem Kastrati, ZRRE, një numër i lëndëve që vijnë nga KEK-u theksohet se është keqpërdorur me proces të kalibrimit mirëpo kur e shikon rrjedhjen e energjisë aktive del se nuk ka ndryshim të konsumit andaj duhet të mbrohen konsumatorët e pafajshëm.

Petrit Pepaj, KEK, mos të fokusohemi shumë në të kaluarën ngase gjithëherë KEK-u është duke u përmirësuar andaj mund të jenë bërë edhe shumë lëshime por që KEK-u çdo lëndë të dyshimtë do ta merr në rishqyrtim ngase as KEK-u nuk është për t'i dëmtuar konsumatorët por ata që e keqpërdorin të ngarkohen me shfrytëzim të paautorizuar por në mënyrë të rregullt.

Në fund është thënë se të gjitha komentet to të shqyrtohen dhe është kërkuar nga pjesëmarrësit që nëse kanë komente të tjera ti dërgojnë me shkrim.

Z. Ali Hamiti në fjalën përmbyllëse të këtij dëgjimi e vlerësoj këtë seancë si të frytshëm, pasi që u dhanë shumë komente dhe u debatua mjaft në lidhje me ndryshimet e propozuara në rregullat për furnizim me energji, dhe rregullën për shkyçje dhe rikyçje, ai tha se ZRRE-ja në këtë seancë të dëgjimit paraqiti variantin e saj se si do të mund të përmirësoheshin këto rregulla dhe mori komentet e pjesëmarrësve të cilat do ti shqyrtoj edhe njëherë me qëllim të përmirësimit të këtyre rregullave. Ai gjithashtu kërkoj nga pjesëmarrësit që të dërgojnë komentet e tyre me shkrim me qëllim që ti ndihmojnë ZRRE-së që këto rregulla të jenë sa më efikase.

Koment: Në këtë proces verbal po mungojnë komentet e bëra nga përfaqësuesit e KEK-ut, andaj të lutem në bashkëpunim me Ganiun të përmbliidhen edhe këto komente. Në veçanti janë me rëndësi komentet në procesin e zgjidhjes së një kontesti kur kemi të bëjmë me vjedhje, abuzim të njehsorit apo shfrytëzim të paautorizuar. Këtu kemi pas dy qasje: një të propozuar nga KEK-u dhe tjetrën të propozuar nga ZRRE: